UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

PUNIM I DIPLOMËS – MASTER

MASA YNDYRORE NË RAPORT ME PARAMETRAT MORFOLOGJIK GJATË FAZËS SË ADOLESHENCËS TE FEMRAT

MENTORI:
Dr. Asoc. Abdulla Elezi

KANDIDATJA:
Nazmie Ibrahimi

Prishtinë, Korrik, 2018

FALËNDERIMI

Falenderimi me i madh shkon per familjen time e cila u kujdes me shume mund dhe sakrifice per t’me mbeshtetur dhe shtyre tjem ktu ku jam sot,i falenderoj per dashurine,mbeshtetjen,inspirimin dhe besimin ne mua.

Do te doja ti shprehja falenderimet me te perzemerta gjithashtu mentorit tim Prof. Dr.Abdullah Elezi i cili ka qene ne gjendje gjithmone te me ndihmoje dhe te me jep sygjerimet dhe keshillat e tije me te mira.

Gjithashtu do te deshiroja te falenderoj te gjithe stafin e profesoreve te fakultetit te Edukimit Fizik dhe Sportit, ku secili prej tyre ka dhene kontributin per te gjitha njohurite qe i kam fituar prej tyre.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 4
1.2 HLUMTIMET E GJERTANISHME 9
2. QËLLIMI I HULUMTIMIT 11
3. HIPOTEZAT THEMELORE 12
4. METODOLOGJIA E PUNËS 13
4.1. MOSTRA E POPULLATËS 13
4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE 14
4.3 TEKNIKA E MATJEVE 15
4.3.1 Teknika e matjeve të ndryshoreve morfologjike 15
4.4 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE 27
5. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI 28
5.1 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR 28
5.1.1 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore 28
5.1.2 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 13 vjeçare të gjinisë femërore 33
5.1.3 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 14 vjeçare të gjinisë femërore 38
5.1.4 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 15 vjeçare të gjinisë femërore 43
5.2 INTERKORELACIONI I NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE 48
5.2.1 Interkorelacioni i ndryshoreve antropometrike te nxënëset e moshës 12 vjeçare 48
5.2.2 Interkorelacioni i ndryshoreve antropometrike te nxënëset e moshës 13 vjeçare 49
5.2.3 Interkorelacioni i ndryshoreve antropometrike te nxënëset e moshës 14 vjeçare 50
5.2.4 Interkorelacioni i ndryshoreve antropometrike te nxënëset e moshës 15 vjeçare 51
5.3 DALLIMI SIPAS GRUPMOSHAVE NË NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE TE NXËNËSET 52
5.4 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE 59
6. PËRFUNDIMI 60
7. LITERATURA 62
REZYME 64
SUMMARY 65

1. HYRJE

Përcaktimi i nivelit të karakteristikave morfologjike te fëmijët, nxënëset e moshës së re shkollore, moshës së adoleshencës së hershme është një detyrë e rëndësishme, në mënyrë që të mund të monitorojmë rritjen dhe zhvillimin e tyre. Përcjellja e tyre duhet të jetë në funksion të detyrave të edukimit fizik bashkëkohor të përqendruar kryesisht në përmirësimin e shëndetit të nxënësve dhe aftësive të tyre krijuese dhe të punës, zhvillimin e aftësive fizike, formimin e aftësive dhe zakoneve të ndryshme, por gjithashtu duke i u përshtatur aktiviteteve fizike

Me termin rritja normale zakonisht kuptojmë rritjen kuantitative të peshës dhe lartësisë dhe ndryshime cilësor në formimin e trupit të fëmijëve. Proceset e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve janë në ndërveprim, dhe është e nevojshme të dijmë jo vetëm nivelet sasiore, por edhe natyrën e marrëdhënieve morfologjik dhe aktivitetet fizike të fëmijëve, në moshë të caktuar, si dhe sipas gjinisë.

Me karakteristika morfologjike të strukturës të statusit psikosomatik të fëmijës nënkuptojmë sistem të caktuar të dimensioneve latente antropometrike pa marr parasysh atë se, a janë zhvilluar këto dimensione nën ndikimin e vaçant të rrethit të jashtëm (me trajning të caktuar) apo jo. Në pajtim me këte, që të vërtetohen në mënyrë shkencore dimensionet latente të kësaj hapsire, zgjidhja është mbështetur në aplikimin e analizës faktoriale dhe analizës regresive. Kështu janë izoluar faktorët antropometrik të cilat janë definuar si dimensione latente (nga seria e variablave manifeste), dhe të cilat janë përgjegjëse për kovariabilitetin e gjendjeve të ndryshme manifeste dhe reaksioneve në atë hapësirë. Para se gjithash, analiza faktoriale mundëson të hyjmë në esencë të strukturës morfologjike dhe dimensioneve të tjera të statusit psikosomatik të njeriut duke zbuluar dimensione latente, të cilat janë përgjegjëse për manifestimet e jashtme të dukurive konkrete.

Antropometrija (somatometrija) është metodë e matjes e trupit të njeriut, respektivisht të disa pjesëve të trupit, me të cilën në mënyrë kuantitative përcaktohen veçoritë morfologjike dhe shikohet pasqyra objektive e gjendjes dhe zhvillimit të njeriut.

Antropometrija si karakteristikë e Antropologjisë është metodë e cila përfshinë matjet e trupit të njeriut, përpunimin dhe studimin e matjeve të fituara. Në sporte të ndryshme si ato amatore ashtu edhe kulminante kjo shërben për:

● Selekcionimin e kandidatve për çdo sport
● Përcjelljen dhe evaulimin e procesit stërvitor
● Vlerësimin objektiv e zhvillimit të përgjithshëm të trupit
● Kontrollimit të gjendjes së ushqyeshmërisë së sportistit
● Përcjelljen e çlodhjes së sportistit në procesin e rehabilitimit

Rëndësia e ndërtimit të trupit për sportet kulminante nuk është e definuar në tërësi si parakusht për arritjen e rezultateve kulminante në sportet kulminante. Prap se prap, hulumtimet kanë treguar se sportistët e suksesshëm tregojnë ngjajshmëri në ndërtimin dhe konstitucionin trupor, dhe këto shprehen më shumë duke përparuar dmth. duke arritur kategori gjith e më të lartë në sportin kulminant. Sipas kësaj, sportistët kulminant, shikuar në aspektin morfologjik janë grup relativisht homogjen, varësisht nga sporti, është i mundur të definohet modeli i cili dëshirohet të arrihet ashtu që të arrihen rezultate kulminante .

Matjet antropometrike shërbejn për përcaktimin e përbërjes së trupit, respektivisht matjes së masës yndyrore dhe asaj joyndyrore. Rezultatet e fituara mund të krahasohen me të dhënat e sportistëve kulminant, sidomos kur bëhet fjalë për disiplinat sportive ku masa yndyrore paraqet hendikep të rëndësishëm, dhe se proceset stërvitore mund ti orientojmë në ndryshimin e atyre veçorive.

Njohja e strukturës së disa dimensioneve të statusit psikosomatik të sportistit, me këtë edhe zhvillimit të tij, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të suksesshme të procesit stërvitor. Duke iu falënderuar numrit të madh të hulumtimeve të cilat janë marrur me përcaktimin e strukturës të disa pjesëve të hapësirës antropometrike, në shkallën e sotme të zhvillimit të shkencës në kulture fizike, me siguri të madhe mund të flasim mbi ekzistimin veçorive të ndryshme.

Faktorët biologjik - Dimensionet morfologjik edhe aftësitë motorike, gjatë jetës tek çdo individ pa ndërprerë ndryshojnë më shumë ose më pak. Këto ndryshime nuk ndodhin ekskluzivisht për shkak të ndikimit të rrethit të jashtëm por janë pasojë e pjesërishme e veprimit të faktorëve biologjik të cilët në organizëm gjenden që nga fillimi

i jetës. Ndikimi i faktorëve biologjik në kushte reale të jetës hyn në bashkëveprim me faktorët tjerë dhe sjell deri tek plakja graduale e cila nuk do të thotë se një plakje graduale ndodh me shpejtësi të njëjtë në të gjitha pjesët e organizmit. Të plakurit është proces biologjik, i cili nuk do të thotë se shkon gjithmonë në mënyrë paralele me numrin e viteve të jetuara. Periudha e plakjes është dukuri e pashmangshme e kushtëzuar me kalimin e kohës në të cilën nuk mundë të kemi asnjë ndikim. Plakja biologjike mundë të përputhet me periudhën e moshës kalendarike, mirëpo, me veprimin e faktorëve të ndryshëm mundë të shpejtohet ose të ngadalësohet, çka rezulton me një shmangie të caktuar të rëndësishme ose të pa rëndësishme ndërmjet moshës dhe plakjes biologjike. Mospërputhja ndërmjet numrit të viteve të jetuara dhe plakjes së organizmit është e lartësisë së ndryshme nga një individ tek tjetri, mirëpo, mundë të ndryshohet edhe tek i njëjti njeri në periudha të caktuara kohore të jetës.

Jetën biologjike mundë ta ndajmë në këto etapa:

a) Fazën e evolucionit ose zhvillimit, e cila karakterizohet me rritjen e dimensioneve trupore, aftësive funksionale, motorike dhe të tjera.
b) Fazën e stagnimit relative, e cila kryesisht zgjat gjatë dhe karakterizohet me një stabilizim relativ morfologjik, funksional dhe motorik. Në këtë faze proceset e plakjes biologjike janë prezentë, mirëpo, aftësitë funksionale dhe motorike nuk ndryshojnë dukshëm.
c) Faza e involucionit ose plakjes së dukshme mund të paraqitet dhe të rrjedh më shpejt ose më ngadalë, dhe karakterizohet me zvogëlim të dukshëm të aftësive funksionale dhe motorike të organizmit.

Njohja e strukturave të disa dimensioneve të statusit psikosomatik të nxënësve (sidomos atij morfologjik), me këte edhe të zhvillimit e tyre, paraqet kushtin themelor për udhëheqje të drejt me procese kinesiologjike drejt zhvillimit të gjithanshëm të rinisë. Duke iu falënderuar hulumtimeve të shumta në të cilat janë angazhuar në vërtetimin e strukturës së disa pjesëve të hapësirës psikosomatike, në shkallën e tashme të zhvillimit të shkencës në kulturën fizike, me bindje dhe siguri të plotë mund të flasim mbi ekzistimin e karakteristikave të ndryshme antropometrike si dhe të aftësive dhe veçorivetë ndryshme.

Definimi i konstitucionit të njeriut e sidomos i sportistit është shumë kompleks për shkak të disa faktorëve të cilët në mënyrë direkte ndikojnë në veçoritë morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të tij. Vet reakcioni i organizmit si tërësi në disa ngacmime respektivisht sjellje në situata të ndryshme të jetes dhe punës përbëjnë grupin e të gjitha veçorive morfologjike, fiziologjike, biokimike dhe psikike të cilët japin karakter konstitucionit të njeriut respektivisht paraqet fenotipin i cili zhvillohet si simbioza e gjenotipit të caktuar i cili është nën ndikimin e faktorëve kompleks të jashtëm.

Shumë autorë dukurin apo nocionin e gjenotipit shpesh e kanë identifikuar me konstitucionin trupur. Mirëpo nocioni i konstitucionit është shumë më i gjerë dhe plastik dhe vet mundësia e formimit në kushte të rrethit në të cilën njeriu jeton, nën veprimin e mënyrës së të jetuarit, punës dhe edukimit na orjenton neve që të kuptojmë se në konstitucionin e njeriut ndikim fundamental kanë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të zhvillimit të njeriut.

Faktorët e rrethit ku hyjnë: pozita sociale (kushtet e vendbanimit, kushtet e shkollimit dhe qëndrimit në hapësirat e shkollës, pozita materiale e familjes, kushtet higjienike, kujdesi shëndetësor) ambienti i pastër si dhe faktorë tjerë të rrethit, si në vendbanimet urbane njashtu edhe në ato rurale (si faktorë ekzogjen) kanë ndikim të rëndësishëm si në zhvillimin morfologjik, ashtu edhe në zhvillimin e aftësive funksionale dhe motorike. Faktorët social dhe faktorët tjerë të rrethit si faktorë të mikrorrethit mundë ti ndajmë në:

a) Faktorë social (kushtet e banimit, shkollimit, pozita materiale, kushtet higjienike, kujdesi shëndetësore, e tjera).
b) Mikroklimatik (temperature, lagështia, përbërja e ajrit, shpejtësia e rrymimit, papastërtia e atmosferës dhe të ngjashme)
c) Mekanike (zhurma, vibracionet)
d) Optike (ndriçueshmëria, karakteristikat e burimeve të ndriçimit, kontrastet, ngjyrat e tjera) Radiacioni (Valët elektromagnetike të gjatësive të ndryshme

White (1982.) ka arrit në përfundimin se statusi socio-ekonomik (SES) që është përcaktuar me matje tradicionale (niveli i të ardhurave, nivelit arsimor dhe statusi i punësimit të kryefamiljarit) pozitivisht, por dobët (jo mjaftueshëm) është i lidhur (r = 0,22), me matjet e arritjeve të njohurive dhe zhvillimit harmonik trupor të fëmijës, ndërsa karakteristikat e familjeve, si klima në familje, kanë treguar lidhje të fuqishme me arritjen

e njohurive te fëmijët e kësaj moshe. Megjithatë, qëndrimet e prindërve rreth edukimit, sjelljet prindërore, aktivitetet kulturore, aktivitetet intelektuale dhe aktivitetet fizike të familjes, nga të cilat shpesh është përcaktuar klima familjare, nga njëherë në mënyrë të pasaktë janë marrë si matje e statusit socio-ekonomik të familjeve.

Një nga detyrat prioritare në punën me fëmijët e moshës shkollore në adoleshencën e hershme ka të bëjë me kujdesin dhe zhvillimin harmonik e tyre optimal. Që të zhvillohet ky proces në mënyrë të duhur, pjesëmarrësit në punën edukative dhe arsimore do të duhet të marrin parasysh ndërveprimin e dimensioneve të ndryshme antropologjike dhe zhvillimin e tyre integral.

Ekspozimi me stimuj të shumëllojshëm (aktivitete fizike, faktor nutritiv, social e tjerë) në mënyrë të pa evitueshme çon në një ndikim më të madh apo më të vogël në dimensionet latente të sistemit antropologjike, si në aspektin sasior ashtu dhe cilësor. Pra Breckenridge, M.E. dhe E.L. Vicent (1960) sqarojnë emocionin e "zhvillimit integral dhe harminik trupor" në këtë mënyrë: "Fëmija përbëhet prej shumë pjesëve që veprojnë në mënyrë të integruar në mes veti. Aftësitë e tij intelektuale janë të lidhur me shëndetin dhe zhvillimin harmonik fizik; Emocionet ndikojnë fuqishëm në shëndetin fizik; Suksesi shkollor ose dështimi, shëndeti fizik ose aftësitë intelektuale ndikojnë në emocione. Përkujdesi ndaj shëndetit fizik dhe zhvillimit të drejt, aftësitë motorike, funksionale dhe intelektuale, interesi për aktivitete fizike dhe liria emocionale janë kërkesa që duhet të përmbushën në institucione parashkollore që thellë dhe përherë ndikojnë në zhvillimin harmonik trupor të fëmijës".

Rritja dhe zhvillimi i fëmijëve ka një vend të rëndësishëm në studimin e përgjithshëm të statusit antropologjik të fëmijëve, si nga pikëpamja e antropologjisë biologjike, ashtu dhe nga pikëpamja e shkencave mjekësore, fiziologjisë, psikologjisë, dhe veçanërisht Kineziologjisë.

Aplikimi i aktiviteteve të organizuara në kohën e lirë të fëmijëve si faktor i rëndësishëm i zhvillimit të drejt dhe harmonik trupor, ka çuar në faktin se fëmijët në kohën e sotme, ndoshta më shumë se kurrë, varen nga potenciali ekonomik dhe kulturor i familjeve të tyre. Prindërit, si dhe mjedisi, kanë një ndikim të madh në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve, dhe për këtë arsye kanë një përgjegjësi të madhe si në zhvillimin psikofizik dhe motorik të tyre, ashtu edhe në aspektin edukativ dhe arsimor.

1.2 HLUMTIMET E GJERTANISHME

Në këtë punimtë do të përmendemi disa nga hulumtimet të autorëve të jashëm dhe të brendshëm që kanë të përbashkët me qëllimet e këtij punimi.

Volbekiene & Griciute (2007) kryen hulumtime të karakterit longitudinal në periudhën 1992-2002 në një mostër prej 2,009 fëmijëve të Lituanisë. Qëllimi i studimit ishte të analizonte dallimet në disa karakteristika antropometrike midis djemve dhe vajzave, të moshës 12, 14 dhe 16 vjeç. Në hapësirën e karakteristikave antropometrike, janë matur disa karakteristika morfologjike tek fëmijët, Rezultatet e arritura u vlerësuan duke përdorur analizën e variancës multivariate (MANOVA). Dallimet nuk ishin të rëndësishme në peshën e trupit, në indeksin e masës trupore (BMI indeksi i masës trupore) dhe në lartësinë e trupit.

Djuraskovic, Kostic, Pantelic, Zivkovic, Uzunović & Purenović (2009) ka kryer një studim për të përcaktuar nëse ka statistikisht dallime të mëdha në karakteristikat antropometrike mes djemve të rinj dhe vajza nga Nishi. Mostra përfshinte 176 nxënës të shkollave fillore, prej të cilëve 91 djem dhe 85 vajza. Në mostrën e instrumenteve matëse janë aplikuar 17 ndryshore antropometrike për matjen e matjeve antropometrike, longitudinale, transversale, masën dhe volumenin trupor dhe indin dhjamor nënlëkuror të trupit, duke përfshirë edhe BMI. Dallimet në mes të matjeve antropometrike të djemve dhe vajzave u përcaktuan duke përdorur t-testin. Rezultatet e fituara nga t-test treguan se nuk kishte dallime të rëndësishme statistikore në matjet e karakteristikave antropometrike. Megjithatë, diferenca numerike në shumë parametra antropometrik mund të gjenden në mes të mostrave, si dhe dallimeve të mëdha brenda grupit që sinjalizojnë heterogjenitetin e grupeve sa i përket karakteristikave antropometrike. Ka dallime në vlerat mesatare numerike te matjete hulumtuara ekzistojn dhe vajzat treguan vlera më të larta në vëllimin e trupit dhe parametrat e indit të yndyrës nënlëkurore, të cilat mund të shpjegohen në bazë të karakteristikave të gjinore.

Milanese, Bortolami, Bertucci, Verlato, & Zancanaro (2010) ka kryer një studim për të vlerësuar marrëdhëniet e mundshme mes karakteristikave antropometrike dhe aftësitë motorike në fëmijët e moshës 6-12 vjeç dhe marrëdhëniet e tyre. Mostra ka përfshir 152 fëmijë të cilët iu nënshtruan matjet standarde antropometrike (BMI,

perimetri bel, perimetri i kofshës, perimetrin e gjoksit, perimetri ikrahut, dhe 5 matje të indit dhja,mor nënlëkuror). Të anketuarit ishin të ndarë në bazë të moshës (6-7, 8-9, 10-12 vjet) dhe gjinisë (meshkuj dhe femra), dhe koeficient korrelacioni sipas Spearmanit është përdorur për të vlerësuar lidhjen mes BMI dhe masave të tjera antropometrike në çdo klasë, si dhe për korrelacion midis testeve antropometrike dhe aftësive motorike. Efekti i moshës, gjinisë, masave antropometrike dhe aftësive motorike është vlerësuar duke përdorur analizën e variancës multivariate (MANOVA). Bazuar në këto rezultate, mund të shihet se aftësitë motorike nuk janë të ndikuara nga indeksi i peshës trupore (BMI), ndërsa indi dhjamor nënlëkuror në korrelacion negativ me shpejtësinë te meshkujt mes moshës 6-7 vjet dhe kërcim të gjatë te femrat moshat 8-12 vjet.

Thaçi & Edona (2016) kanë kryer një studim për të përcaktuar nivelin e zhvillimit morfologjik dhe motorik ë nxënëseve të moshës nga 12 deri në moshën 15 vjeçe domethënë zhvillimit morfologjik dhe motorik të nxënësëve nëpër periudha kohore të rritjes dhe zhvillimit. Në këtë punim (hulumtim) janë përfshirë 120 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 120 nxënës të gjinisë femrore, gjithsejt në hulumtim janë përfshirë 240 nxënës të Shkollës fillore të mesme të Ulët, "Dëshmorët e Kombit", " në Kamenicë. Nxënësit e dy gjinive kanë qenë të ndar në 4 grupe. Rezultatet e fituara kanë treguar se është futuar një dallim i rëndësishëm statistikor në mes nxënëseve të ndara sipas moshës kalendareke në zhvillimin morfologjik.

2. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Nga njohuritë e gjertanishme mbi zhvillimin e njeriut si te femrat ashtu edhe te meshkujt mund të themi se gjatë fazës së zhvillimit të shpejt nuk kemi përherë raport të drejt në mes zhvillimit morfologjik dhe atij kalendarik. Për këte edhe hulumtimet shpesh herë janë të orjentuara edhe në përcaktimin e zhvillimit të dimensioneve antropometrike gjatë kësaj faze të zhvillimit.

Qëllimi primar i hulumtimit është vërtetimi i nivelit të zhvillimit të karakteristikave morfologjike si dhe vërtetimi i dallimit në mes nxënësve të moshës 12, 13, 14 dhe 15 vjeçare në disa ndryshore morfologjike.

Nga kjo del edhe qëllimi sekundar i këtij punimi, të vërtetohet ndryshimi i masës yndyrore në raport me parametrat morfologjik gjatë fazës së adoleshencës (pubertetit) te femrat. Në bazë të këtyre qëllimeve, gjatë kësaj faze të zhvillimit morfologjik te femrat mund të arrijm deri te informacionet se masa yndyrore në cilën moshë të adoleshencës është më e shprehur në raport me masën aktive trupore ose muskulare.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Hipotezat e parashtruara për këtë punim do të jenë në harmoni me qëllimin e këtij hulumtimi:

H_{01} – Shpërndarja e rezultateve antropometrike të cilat do të fitohen nga matjet do të jenë në kuadër të shpërndarjeve normale.

H_{02} – Koeficientët e matricës së korelacionit të ndryshoreve antropometrike do të jenë statistikisht të të rëndësishme në mes veti.

H_{03} – Do të fitohen dallime të rëndësishme statistikore në mes nxënëseve të moshës 12, 13, 14 dhe 15 vjeçare në parametrat antropometrik.

H_{04} – Raporti në mes masës yndyrore trupore dhe parametrave tjerë antropometrik do të jetë më i shprehur te femrat e moshës 15 vjeçare.

4. METODOLOGJIA E PUNËS

4.1. MOSTRA E POPULLATËS

Popullata nga e cila do të nxjerrët mostra e të testuarve është definuar si popullatë e nxënëseve të moshës 12, 13, 14 dhe 15 vjeçare të Shkollës së mesme të ulët "Gjon Serreçi" në Ferizaj.

Mostra ka përfshirë 4 grupe me nga 30 nxënës të gjinisë femërore. Gjithsejtë në këtë punim janë përfshir 120 nxënëse të moshës 12, 13, 14 dhe 15 vjeçare. Matjet janë realizuar gjatë muajti shkurt të vitit kalendarik 2017/2018.

Parakusht për ti kryer matjet në këtë shkollë ka qenë gatishmëria e Drejtorisë së shkollës dhe nxënësve të pranojnë që ti nënshtrohen matjeve antropometrike në mënyrë të organizuar.

4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE

Për identifikimin e karakteristikave morfologjike te nxënet e moshës 12, 13, 14 dhe 15 vjeçare do të aplikohen këta parametra antropometrik:

ALART – Lartësia e trupit
AGJEK – Gjerësia e krahëve
AGJKË – Gjatësia e këmbës
APESH – Pesha e trupit
APKRA – Perimetri i krahut
APNGJ – Perimetri i nëngjurit (drejtqëndrim)
AIDSH – Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës
AIDHK – Indi dhjamor nën lëkuror i krahut
AIDHB – Indi dhjamor nën lëkuror i barkut
AIDHN – Indi dhjamor nën lëkuror i nëngjurit
AMATR – Masa aktive trupore
AMPTR – Masa pasive trupore (yndyrore)

Përcaktimi i masës jo yndyrore trupore dhe yndyrore tek femrat është realizuar në bazë të formulës të cilën e ka propozuar **Willmore** me bashkëpunëtor (1969).

LBM= 8.629 + 0.680 X PT – 0.163 X AIDSH - 0.100 X AIDHN – 0.054 X AIDHK

4.3 TEKNIKA E MATJEVE

4.3.1 Teknika e matjeve të ndryshoreve morfologjike

1. Lartësia e trupit (ALARTË)

Ndryshoret antropometrike janë matur sipas mënyrës si vijon:

Mjetet: Antropometri sipas Martinit

Lartësia e trupit është matë me antropometër, i testuari që është matë ka qenë i zbathur, në veshje sportive dhe ka qëndruar në bazamentin e fortë horizontal të antropometrit. Koka e tij ka qenë në atë pozitë që skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale (horizontalja e Frankfurtit).

Qëndrimi i trupit të entitetit ka qenë në i relaksuar dhe i drejtë, shputat e bashkuara, ndërkaq matësi ka qëndruar në të majtë të entitetit.

Pasi që e kontrollon pozitën e entitetit dhe të instrumentit (antropometri), matësi e lëshon krahun horizontal të antropometrit deri në pjesën e eperme të kokës (pika më e lartë e kokës – vertex) dhe e lexon në shtyllën e antropometrit pikën e lartësisë.

Foto 1. Matja e lartësisë së trupit

2. Gjerësia e krahëve (AGJEK)

Gjerësia e krahëve, është matur me antropometer. I testuari qendron me duar te hapura horizontalisht ne nivel te kraheve, dhe me shuplaka te kthyera nga poshtë . Matja kryhet nga daktilioni i dores se djatht deri tek daktilioni i dores se majt, rezultati lexohet me saktesi 0.1 cm.

Foto 2. Matja e gjerësisë së krahëve

3. Gjatësia e këmbës (AGJKË)

Gjatësia e këmbës është matet me antropometër sipas martinit.

I testuari i zbathur dhe me brekë të lëshuara, ka qëndruar në drejtëqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Maja e akrepit të antropometrit vendoset në anën e përparmë të kokërdhokut (spina iliaca anterior superior) dhe lexohet lartësia e sajë nga baza horizontale e antropometrit. Rezultati në fletëtestim shënohet me saktësi prej 0.1 cm.

Foto 5. Matja e gjatësisë së këmbës



4. Pesha e trupit (APESH)

Pesha e trupit është me peshorën antropometrike, e cila mundëson saktësinë e matjës prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vihet në pozitë horizontale dhe në bazament të fortë. I testuari është i zbathur në brekë të shkurtëra, qëndron i qetë, në këmbë, në mes të peshorës. Pasi të qetësohet boshti (treguesi) i peshorës në pozitën ekuilibruese lexohet rezultati. Leximi i rezultatit bëhet me saktësi 0.1 kg.

Foto 7. Matja e peshës së trupit

5. Perimetri i krahut (APKRA)

Perimetri i krahut (në fleksion dhe i kontrahuar) është matë me traken matëse gjysmë plastike. Para matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me dorën të lakuar më brryl dhe të shtrënguar. Traka matëse mbështjellët rreth krahut (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit. Rezultati lexohet me saktësi prej o,1 cm.

Foto 9. Matja e perimetrit të krahut

6. Perimetri i nëngjurit, kërcirit – APNGJ (në drejtqëndrim)

Është matë me traken matëse gjysmë plastike. Para matjes e testuari është i zbathur dhe në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim. Traka matëse mbështjellët rreth pjesës së nëngjurit (pjesës më të trashë) në boshtin e tij në nivel i cili i përgjigjet mesit ndërmjet zogut të këmbës dhe pjesës së eperme të tibies. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 5. Matja e perimetrit të kërcirit (APERKË)

7. Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës (AIDSH) (nën këndin e poshtëm të shpatullës).

Indi dhjamor nën lëkuror i shpinës është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes e testuara është në veshje sportive dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën drejtpërdrejt nën këndin e poshtëm të shpatullës së majtë, duke pasur kujdes që të mos kap indin muskulor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majat e akrepave të kaliperit. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 6. Matja e indit dhjamor nën lëkuror të shpinës (AIDHSH)

8. Indi dhjamor nën lëkuror i krahut (AIDHK)

Indi dhjamor nën lëkuror i krahut është matë me kaliper "John Bull" i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes e testuara është në veshje sportive qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vërtikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme të krahut të majtë (tek muskuli triceps) në vendin e cila i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit, duke patur kujdes që most ë kapet indi muskulor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 7. Matja e indit dhjamor nën lëkuror të krahut (AIDHKR)



9. Indi dhjamor i barkut (AIDHB)

Indi dhjamor i barkut është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahve të kaliperit në lëkur të jet 10gr/mm². Para matjes e testuara është në veshje sportive dhe qëndron në drejtëqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë dhe relaksim të muskujve të barkut. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën në anën e majtë të barkut në nivel të kërthizës (ombilikusit) dhe 5 cm në të majtë nga ai, duke patur kujdes që të mos kap edhe inde muskulore , kap palën (rrudhën) me majet e akrepave të kaliperit(të vendosur medialisht nga majet e gishtrinjëve). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 8. Matja e indit dhjamor nën lëkuror të barkut (AIDHBA)

10. Indi dhjamor nën lëkuror i nëngjurit (AIDHN) është matë me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vërtikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme nga jasht e nëngjurit të majtë (tek muskuli triceps), duke pasur kujdes që most ë kapet indi muskulor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 8. Matja e indit dhjamor nën lëkuror të nëngjurit (AIDHN)

11. Masa aktive trupore (jo yndyrore) trupore (MATAKT) është fituar në bazë të formulës e cila është dhënë më poshtë (Willmorit me bp., 1969) . Numri 8.629 mblidhet me numrin i cili fitohet nga shumëzimi i numrit (0.680 dhe peshës së trupit (APESH) e që nga ky numër zbritet numri i fituar 0.163 i cili shumëzohet me vlerën e indit dhjamor të shpinës (AIDSH) që nga numri i fituar zbritet numri 0.100 i shumzuar me vlerën e indit dhjamor të nëngjurit (AIDHN) që nga numri i fituar zbritet numri 0.054 i shumzuar me vlerën e indit dhjamor të krahut (AIDHK).

Për meshkuj

LBM= 8.629 + 0.680 X PT – 0.163 X AIDSH - 0.100 X AIDHN – 0.054 X AIDHK

12. MATPAS Masa pasive trupore ose jo aktive (yndyrore) është fituar në bazë të formulës e cila është dhënë më poshtë (Willmorit me bp., 1969) . Nga pesha trupore (APESH) zbritet numri 8.629 mblidhet me numrin i cili fitohet nga shumëzimi i numrit (0.680 dhe peshës së trupit (APESH) e që nga ky numër zbritet numri i fituar **0.163** i cili shumëzohet me vlerën e indit dhjamor të shpinës (AIDSH) që nga numri i fituar zbritet numri 0.100 i shumzuar me vlerën e indit dhjamor të nëngjurit (AIDHN) që nga numri i fituar zbritet numri 0.054 i shumzuar me vlerën e indit dhjamor të krahut (AIDHK).

Për femra

LBM= PT – (8.629 + 0.680 X PT – 0.163 X AIDSH - 0.100 X AIDHN – 0.054 X AIDHK)

4.4 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë që kërkimi shkencor që të jep zgjidhje të kënaqshme, është e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komparative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo variabël antropometrike, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)
- Koeficienti i variacionit (Kv)

2. Lakorja e distribucionit ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë **(„skjunis”),** dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës ("'**kurtozis**").

4. Analiza univariante e variances – ANOVA. Për qëllim të hulumtimit do të na shërbej koeficienti i dallimit Scheffe**.**

5. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI

5.1 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR

5.1.1 Interpretimi i parametrave themelor statistikor ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore

Në tabelën 1 janë të paraqitur parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike te nxënëset. Në këtë tabela janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – anim, asimetri), shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet) dhe homogjeniteti.

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike te fëmijët e moshës 12 vjeçare të gjinisë femërore

	N	Min	Max	Mean	Std. Dev	Skew	Kurt	Kv
ALART	30	146.00	166.00	153.50	5.89	.597	-.725	3.84
AGJEK	30	143.00	166.00	150.97	6.93	.826	-.500	4.59
AGJKË	30	83.00	102.00	91.77	5.16	.079	-.465	5.63
APESH	30	38.00	56.00	45.53	5.64	.112	-1.182	12.39
APKRA	30	19.00	27.00	23.02	2.09	.148	-.546	9.08
APNGJ	30	29.00	37.00	32.82	2.16	.386	-.434	6.59
AIDSH	30	7.00	19.00	12.97	3.61	-.117	-1.296	27.88
AIDHK	30	6.00	24.00	14.93	5.28	.250	-.436	35.34
AIDHB	30	8.00	28.00	15.93	5.64	.140	-.859	35.42
AIDHN	30	6.00	26.00	13.80	5.50	.212	-.714	39.84
AMATR	30	31.20	41.65	35.29	2.90	.485	-.568	8.23
AMPTR	30	5.81	15.00	10.24	2.98	-.082	-1.304	29.13

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, lartësia e trupit (ALART) është 153.50 cm. Rezultati minimal (146.00 cm) dhe ai maksimal (166.00 cm) i ndryshores lartësia e trupit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënëseve në këtë ndryshore antropometrike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Nxënëset e moshës 12 vjeçe në bazë të lartësisë së trupit paraqiten si grup homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit

(Kv=3.84) me një numër më të madhe të rezultateve kah ato më të ulëta. Matjet e lartësisë së trupit tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri dhe shpërndarje normale platokurtike.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, gjerësia e krahëve (AGJEK) është 150.97 cm. Rezultati minimal (143.00 cm) dhe ai maksimal (166.00 cm) i ndryshores gjerësia e krahëve tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënëseve në këtë ndryshore antropometrike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Nxënëset në bazë të gjerësisë së krahëve paraqiten si grup homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit (Kv=4.59) me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Matjet e gjerësisë së krahëve tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri dhe shpërndarje normale platokurtike.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, gjatësia e këmbës (AGJKË) është 91.77 cm. Rezultati minimal (83.00 cm) dhe ai maksimal (96.00 cm) i ndryshores gjatësia e këmbës tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënëseve në këtë ndryshore antropometrike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Nxënëset në bazë të gjatësisë së këmbës paraqiten si grup homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit (Kv=5.63) me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Matjet e gjatësisë së këmbës tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri dhe shpërndarje normale platokurtike.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, pesha e trupit (APESH) është 45.53 kg. Rezultati minimal (38.00 kg) dhe ai maksimal (56.00 kg) i ndryshores pesha e trupit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënëseve në këtë ndryshore antropometrike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Nxënëset në bazë të peshës së trupit paraqiten si grup mesatarisht homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit (Kv=12.39) me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Matjet e peshës së trupit tregojnë se

edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri dhe shpërndarje normale platokurtike.

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, perimetri i krahut (APKRA) është 23.02 cm. Rezultati minimal (19.00 cm) dhe ai maksimal (27.00 cm) i ndryshores perimetri i krahut tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënëseve në këtë ndryshore antropometrike, si dhe një anim të lehtë të rezultateve ka ato më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Nxënëset në bazë të perimetrit të krahut paraqiten si grup mesatarisht homogjen që e vërteton koeficienti i variacionit (Kv= 9.08) me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Matjet e perimetrit të krahut tregojnë se edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë për një asimetri dhe shpërndarje normale platokurtike.

